

Çertifikatë vlefshmërie për banesën (Il certificato di idoneità alloggiativa)

Çfarë është

Kjo çertifikatë është një dokument që tregon vlefshmërinë e banesës sipas disa parametrave të vendosura nga normativa në fuqi.

Nevojitet në këto raste:

- bashkim familjar, që do të thotë, hyrja nga jashtë vendit e familjarëve të punëtorit emigrant është i autorizuar;
- për leje qëndrimi pa afat CE për emigrantët punëtorë dhe fimmiljarët e tij/saj në ngarkim;
- nënshkrimin e kontratës së punës

Kush mund të aplikojë

Kjo çertifikatë mund të kërkohet nga:

- pronari i banesës;
- nga qiramarrësi që ka emrin në kontratë;
- nga çdo person që është resident, apo banues apo dhe thjeshtë si mysafir në atë banesë (ospite).

Si mund të aplikojë

Kërkesa duhet të paraqitet nga aplikanti duke përdorur vetëm formularët që gjenden në këtë faqe interneti "Certificato di idoneità alloggiativa" duke bashkangjitur dokumentat e mëposhtme:

- fotokopje të kontratës të regjistruar, të shitblerjes, të qerasë, të dhënies hua në mënyrë gratuite të banesës "comodato";
- planimetria e shtëpisë e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Firences (Agenzia del Territorio di Firenze) konforme gjëndjes aktuale të banesës, apo fotokopje e plotë jo e reduktuar apo e zmadhuar, jo e pjeshme, e lexueshme dhe me gjithë të dhënat e duhura, adresa: emrin e rrugës numrin, katin, si dhe këto të dhëna: foglio, particella, subalterno; në rast se keni nevojë të fotokopjoni planimetrinë e lëshuara nga kjo Zyrë në fletën A3, është shumë e rëndësishme që kjo të fotokopjohet po në të njëjtin format A3, duke shmangur riprodhimet në 2 fletë të formatit A4; pranohet gjithashtu si alternativë dhe fotokopje e plotë e planimetrisë së banesës e depozituar pranë një administrate publike, ose planin apo hartat origjinale të banesës në shkallë 1:50 ose 1:100 të hartuara nga një teknik i kualifikuar për ushtrimin e profesionit;
- fotokopje të një dokumenti identifikimi të vlefshëm. Në rast se kërkesa e kësaj çertifikatë është për motiv bashkim familjar, nevojitet edhe fotokopja e pasaportës të personit që do të vijë nga jashtë;
- fotokopje e lejes së qëndrimit/ apo e kërkesës për leje qëndrimi, në rast rinovimi dhe mandatin (ricevuta) e lëshuar nga operatori i Postës.
- deklarata e korrispondencës midis planimetrisë dhe gjëndjes aktuale të banesës;
- në rast së aplikanti është si i ftuar (ospite) në atë banesë nevojitet deklarata e mikpritësit;
- një pullë prej 16 Euro në fillim kur paraqitet kërkesa, dhe një tjetër po prej 16 euro kur tërhiqet kjo çertifikatë;
- mandatpagesa për të drejtat e sekretarisë

Sëbashku me aplikimin duhet të jetë i bashkangjitur mandatpagesa për të drejtat e sekretarisë prej **30 euro**.

Në rast se aplikuesi prezanton sëbashku me formularin e aplikimit edhe çertifikatën e ISEE të vlefshme, ku rezulton vlera e barabartë apo më e ulët se 8.000,00 euro, kjo shifër ulet në 5,16 euro.

Kjo pagesë duhet bërë nëpërmjet një boletini postar në këtë numër llogarie: 125500, në emër të "Comune di Campi Bisenzio - Servizio di Tesoreria Comunale".

Formularët

Në faqen e internetit "Certificato di idoneità alloggiativa" është e mundur të shkarkohen formularët e mëposhtëm:

Formulari i aplikimit (Modello di domanda)

Deklaratë zëvendësuese që vërteton që banesa është e njëjtë me origjinalin e planimetrisë (Dichiarazione sostitutiva di copia conforme all'alloggio della planimetria)

Deklaratë për mikpritësin (Dichiarazione di ospitalità)

Letër autorizimi për tërheqjen e çertifikatës (Modulo per la delega al ritiro del certificato)

Informacione të mëtejshme

Për informacione të mëtejshme si ndihmë për plotësim formularësh, dorëzimin e tyre në mënyrë korrekte me gjithë dokumentacionin e duhur, si dhe për tërheqjen në fund mund të drejtoheni në:

Zyrën e pritjes për qytetarët e huaj (Sportello Accoglienza cittadini stranieri)

Via Limite, 15 - Villa Montalvo

Çdo të martë dhe të mërkurë nga ora 9.00 deri më 13.00, të enjte nga ora 15.30 deri më 18.00.

Çertifikata mund të tërhiqet edhe nga një person tjetër përveç aplikuesit, por me kusht që të ketë letrën e autorizimit.

Shembull si llogariten metrat e banesës

Një shembull i thjeshtë mund të gjendet tek faqa e internetit të "Certificato di idoneità alloggiativa" ku tregohet një skemë llogaritëse që mund të jetë e dobishme për të kuptuar mënyrën se si, në varësi të arsyes për të cilën kërkohet kjo çertifikatë, llogariten hapësirat e banesës tuaj.

Afati i nevojshëm për lëshimin e çertifikatës

Nëse motivi i aplikimit është për bashkim familjar apo për rinovim leje qëndrimi, gjithnjë nëse nuk kërkohen dokumenta shtesë për praktikën e dorëzuar, afati për lëshimin e kësaj çertifikate është 60 ditë duke nisur që nga data e paraqitjes të aplikimit.

Nëse motivi i aplikimit është për nënshkrimin e kontratës së punës si kur jeni me leje qëndrimi apo jo (Decreto Flussi e Decreto emersione lavoro) kohëzgjatja për lëshimin e këtij dokumenti është 120 ditë, gjithnjë duke patur parasysh që praktika nuk ka nevojë për dokumenta shtesë.